



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.09.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 8, 9, 10, 11, 12, 15 dhe 16 korrik 2019.
2. Miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 2-20 shtator 2019.
3. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë".
4. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit, për transportin detar".

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Alban Zeneli, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Xhemal Qefalia dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Edmond Leka, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Spartak Braho, Damian Gjikhuri, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Anila Denaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Astrit Kuka – Përgjegjës i Sigurimeve Shoqërore

Artan Shkreli – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimio Plaku – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bledar Karoli – Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elson Thana – Specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Sot kemi mbledhjen e parë të Komisionit të Ligjeve për sesionin V të legjislaturës IX.

Në rendin e ditës kemi 4 çështje, por, para se të fillojmë mbledhjen e komisionit, është në traditën e Komisionit të Ligjeve që me fillimin e sesionit të ri të bëhet një përmbledhje e punës së këtij komisioni për sesionin që lamë pas, pra për periudhën janar-korrik të vitit 2019, si dhe për të shpalosur objektivat e këtij komisioni për sesionin e ri që fillojmë sot. Në fakt, nuk do t'ju mbaj gjatë, por ia vlen t'i bëjmë prezente treguesit tonë të punës për sesionin që lamë pas, edhe në respekt të medieve, që sot i kemi prezentë këtu, por edhe për opinionin publik.

Komisioni i Ligjeve për periudhën janar-korrik 2019 ka pasur një aktivitet të ngjeshur në të 3 komponentët e veprimtarisë parlamentare për sa u përket procesit legjislativ, procesit të mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar, si edhe të procesit të zgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të krerëve të institucioneve të pavarura, kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

Në lidhje me treguesit, Komisioni i Ligjeve, në përbërje të të cilit janë edhe tri komisione: Nënkomisioni i të Drejtave të Njeriut, Nënkomisioni i Administratës Publike dhe Nënkomisioni për Pushtetin Vendor, ka zhvilluar 56 mbledhje, nga të cilat 50 mbledhje janë mbledhje të komisionit dhe 4 mbledhje të nënkomisioneve, 1 mbledhje e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut, 1 e Nënkomisionit të Administratës Publike dhe 1 mbledhje e Nënkomisionit për Çështjet Vendore. I krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, numri i mbledhjeve të Komisionit të Ligjeve për sesionin që lamë pas është rritur me 5 mbledhje më shumë.

Për sa i përket procesit legjislativ, komisioni ka shqyrtuar 36 projektligje, 28 prej të cilave të propozuara nga Këshilli i Ministrave, 7 kanë qenë nisma deputetësh dhe risi është 1 nismë e 37 mijë zgjedhësve.

Nga projektligjet e shqyrtuara në komision kanë qenë 7 nisma të reja ligjore, 12 kanë qenë shtesa dhe ndryshime në legjislacionin në fuqi dhe 17 kanë qenë ratifikime marrëveshjesh ndërkombëtare.

Ka shqyrtuar 12 projektligje në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe 24 projektligje në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi. Numri i projektligjeve të shqyrtuara në cilësinë e komisionit përgjegjës në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018 është rritur me 2 projektligje, ndërsa numri i nismave ligjore të shqyrtuara nga Komisioni i Ligjeve si nisma deputetësh është rritur me 4 projektligje krahasuar me vitin 2018.

Risi për veprimtarinë legislative të komisionit ishte shqyrtimi i një nisme ligjore të propozuar nga 37 mijë e 527 zgjedhës “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal”.

Përmbyllja e shqyrtimit dhe e miratimit të paketës ligjore të reformës së sistemit të drejtësisë shënoi një tjetër sukses për veprimtarinë legislative të komisionit. Këtu dua të përshëndes edhe opozitën, pasi në fund të sesionit edhe me konsensusin e opozitës, me shumicën e cilësuar prej 3/5-ash, ne miratuam edhe ndryshimet në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si reflektim i rekomandimeve të bëra nga Gjykata Kushtetuese.

Në kuadër të përmirësimit dhe përafrimit të projektligjeve me standardet më të mira të Bashkimit Europian, komisioni ka miratuar 278 amendamente, të cilat janë miratuar edhe në seancë plenare.

Në cilësinë e komisionit përgjegjës, komisioni ka shqyrtuar dhe ka miratuar 8 projektvendime, nga të cilat 4 projektvendime për miratim strukture dhe organike, 2 projektvendime për zgjedhjen, emërimin, dhënien e pëlqimit të institucioneve të pavarura dhe 2 projektvendime për çështje të tjera. Janë shqyrtuar dhe rrëzuar nga komisioni 3 dekrete të Presidentit të Republikës për rishqyrtim të ligjit janë krahasuar me vitin 2018, ku nuk patëm asnjë dekret të rrëzuar.

Gjithashtu, komisioni, në cilësinë e komisionit përgjegjës, ka shqyrtuar dhe ka miratuar një projektrezolutë për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë, krahasuar me asnjë projektrezolutë të shqyrtuar gjatë 2018. Janë zhvilluar 2 seanca dëgjimore publike për sa i përket procesit legjislativ, numër i barabartë me numrin e të gjitha seancave dëgjimore të zhvilluara për vitin 2018.

Për sa i përket komponentit të dytë, procesit të mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar, komisioni i ka kushtuar rëndësi këtij komponenti dhe, krahas raportimeve që janë bërë në komision nga institucionet e pavarura dhe ato kushtetuese, komisioni në sesionin që lamë pas është kujdesur që edhe në vizitat studimore në këto institucione nga vetë anëtarët e Komisionit të Ligjeve, të lënë edhe detyra konkrete për zbatim.

Në sesionin që lamë pas komisioni ka zhvilluar 15 seanca dëgjimore dhe ka analizuar raportet vjetore të institucioneve të pavarura, që janë në sferën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve, ku janë miratuar 9 projektrezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së tyre. Krahasuar me vitin 2018, numri i seancave dëgjimore të zhvilluara në kuadër të procesit të mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar ka pësuar një rritje me 5 seanca.

Gjatë periudhës janar-korrik 2019 komisioni, së bashku me nënkomisionet përbërje të tij, ka zhvilluar 3 vizita informuese: te Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Autoriteti për Informimin mbi Dosjet dhe Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen nga Diskriminimi.

Për sa i përket komponentit të tretë, procesit të zgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të krerëve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, Komisioni i Ligjeve ka zhvilluar 5 seanca dëgjimore, konkretisht lidhur me plotësimin e tri vendeve për komisioner tek Avokati i Popullit, procedurën e përzgjedhjes paraprake të kandidaturave për anëtarë të Shqipërisë pranë Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor dhe Degradues; plotësimin e vendit vakant për anëtar të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe ka shqyrtuar kërkesën e një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta.

Numri i seancave dëgjimore në këtë proces, krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar një rritje me 3 seanca. Këta ishin në mënyrë të përmbledhur treguesit e punës së Komisionit të Ligjeve në të 3 komponentët e veprimtarisë parlamentare për periudhën janar-korrik 2019. Unë në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Ligjeve, e konsideroj një sesion të suksesshëm dhe këtu gjej rastin të falënderoj të gjithë kolegët e mi të Komisionit të Ligjeve, të maxhorancës, por edhe të opozitës për konstruktivitetin e treguar në miratimin e projektligjeve, por edhe për mbylljen me sukses të veprimtarisë parlamentare në sesionin që lamë pas.

Në lidhje me objektivat e komisionit për sesionin e ri parlamentar, objektivi primar mbetet ndjekja e zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë, për aq sa është e mundur dhe brenda kompetencave që i ngarkon ligji këtij komisioni në drejtim të plotësimit të vendeve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, që i takojnë Kuvendit, nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të paketës ligjore të reformës në drejtësi dhe zgjedhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe në përputhje me programin e Kuvendit dhe afateve të përcaktuara në Rregullore. Po ashtu, për sa i përket komponentit të dytë, që është procesi i mbikëqyrjes dhe i kontrollit parlamentar, do të vazhdojë të mbetet në fokusin e komisionit monitorimi dhe mbikëqyrja parlamentare, duke shtuar numrin e vizitave informuese dhe monitoruese pranë institucioneve që janë në sferën e veprimtarisë së Komisionit të Ligjeve. Po ashtu, në bashkëpunim me Shërbimin e Monitorimit të Kuvendit, do të marrim masat e duhura konform Rregullores së Kuvendit për të plotësuar të gjitha vendet vakante të krijuara në institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, që janë në sferën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve. Si objektivi kryesor mbetet që të gjithë veprimtaria

parlamentare në të tre komponentët në këtë komision të synojë edhe konsensusin e deputetëve të opozitës, pasi i gjithë procesi ligjvënës duhet të jetë në interesin më të mirë të publikut dhe qytetarëve shqiptarë.

Duke ju uruar një sesion të ri parlamentar të mbarë dhe me krahë të lehta, mua nuk më mbetet gjë tjetër vetëm se t'ju them sukses dhe të na shkojë mbarë e me krahë të lehta të gjithëve ne që jemi deputetë të këtij komisioni, maxhorancë-opozitë, por edhe medieve që kanë qenë, janë dhe do të mbeten partnerë shumë të rëndësishëm në drejtim të transparencës së veprimtarisë parlamentare të këtij komisioni, sepse, në fund të fundit, fokusi janë qytetarët shqiptarë.

Shumë faleminderit!

I kërkoj ndjesë ministres Denaj për këtë vonesë, sepse, në fakt, kjo është mbledhja e parë e sesionit të ri parlamentar.

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Pika e parë është miratimi i procesverbaleve të datave 8,9,10,11,12,15 dhe 16 korrik të vitit 2019. Procesverbalet e mbledhjeve të komisionit ju kanë ardhur, kolegëve deputetë, nëpërmjet postës elektronike. A ka komente, sugjerime, vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Atëherë, miratohen procesverbalet e mbledhjeve të datave 8,9,10,11,12,15 dhe 16 korrik të vitit 2019.

Pika e dytë e rendit të ditës është miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 2-20 shtator 2019 draftalendarin e keni mbi tavolinë. A ka sugjerime? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Me teknologjinë e re letra shkon drejt reduktimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Dakord me draftkalendarin? Atëherë miratohet draftkalendarin i punimeve të komisionit për periudhën 2-20 shtator 2019.

Pika e tretë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë”. Komisioni ynë në shqyrtimin e këtij projektligji është komision për dhënie mendimi, relatore do të jetë kolegja Klotilda Bushka.

Kemi prezent sot në komision nga Ministria e Financave ministren, zonjën Anila Denaj.

Zonja Denaj, mirë se keni ardhur sot në Komisionin e Ligjeve!

Ministrja shoqërohet nga zëvendësministrja, zonja Dajna Sorensen dhe zoti Astrit Kuka.

Zonja Ministre, ju lutem një prezantim të kësaj marrëveshjeje për kolegët e komisionit, pastaj fjalën e ka relatorja, si dhe pyetje dhe diskutime nga kolegët.

Edhe një herë, mirë se erdhët në komision!

Fjala është për ju.

Anila Denaj- Shumë faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ju uroj sesion të mbarë dhe uroj të fillojmë mbarë me këtë projektligj!

Ky projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe Kanadasë” paraqitet për shqyrtim sot dhe është pjesë e procesit të koordinimit të skemave të mbrojtjes shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera, ashtu siç është parashikuar në programin politik të qeverisë. Kjo marrëveshje vjen në vazhden e një sërë marrëveshjeve në këtë fushë, siç janë: Belgjika, Luksemburgu, Maqedonia e Veriut, Hungaria, Rumania, Republika Çeke, Gjermania, Austria, Turqia dhe Kosova. Negociatat për finalizimin e marrëveshjes dypalëshe në fushën e mbrojtjes shoqërore midis Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë janë zhvilluar në tri raunde. Raundi i parë është zhvilluar në Shqipëri në datat 7-8 tetor të vitit 2013; raundi i dytë është zhvilluar në Kanada, 26-30 maj të vitit 2014, dhe raundi i tretë u zhvillua në Shqipëri në datat 1-4 maj të vitit 2014. Gjatë këtyre raundeve janë sqaruar skemat e sigurimeve shoqërore të të dy vendeve dhe më pas është vazhduar puna për hartimin e marrëveshjes kuadër dhe marrëveshjes administrative, ku janë prezantuar formularët paraprakë në zbatim të kësaj marrëveshjeje. Marrëveshja u miratua në parim më vendim të Këshillit të Ministrave nr. 336, datë 22.04.2015 dhe u nënshkrua në datën 30 prill të vitit 2019 në Kanada nga ambasadori i Republikës së Shqipërisë dhe ministrja e Punëve të Jashtme kanadeze. Pas nënshkrimit, ratifikimi është procesi përfundimtar me anë të të cilit Kuvendi i Shqipërisë jep miratim përfundimtar të projektligjit. Marrëveshja e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë konsiston në ofrimin e përfitimeve të sigurimeve shoqërore dhe bazohet në parimin e trajtimit të barabartë të punëtorëve në punësim, trajtime, përfitime dhe të ardhura. Gjithashtu, ajo garanton që personat që lëvizin nga një vend në tjetrin dhe personat në varësi të tyre e të mbijetuarit të ruajnë të drejtat e fituara apo që janë duke i fituar ato. Bashkimi i periudhave të siguruara, sipas legjislacioneve kombëtare të ndryshme, merret në konsideratë për të siguruar të drejtën e përfitimeve dhe llogaritjen e tyre. Objekt i kësaj marrëveshjeje janë përfitimet nga skema shqiptare e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe akti i sigurimeve për të moshuarit e planit kanadez, i pensionit në Kanada. Palët kanë rënë dakord të japin përfitime në para për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe ato

familjare, bazuar në legjislacionet respektive të mbrojtjes shoqërore. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje krijon mundësinë e përfitimit të pensioneve për rreth 70 mijë qytetarë shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në Kanada, si dhe shtetasve kanadezë, të cilët vijnë për të punuar në Shqipëri. Në bazë të marrëveshjes, asnjë qytetar nuk do të humbasë asnjë ditë kalendarike, pavarësisht ku ka punuar, pasi bashkimi i periudhave do të bëjë të mundur plotësimin e kushteve ligjore për përfitimin e pensionit në të dy vendet. Gjithashtu, pjesë e kësaj marrëveshjeje është edhe eksporti i pensioneve, që do të thotë se pensioni që do t'u paguhet qytetarëve shqiptarë në vendin që do të zgjedhin të jetojnë, shtetasit shqiptarë do të kenë mundësi ta marrin pensionin kanadez edhe nëse zgjedhin të jetojnë në Shqipëri, duke mos humbur asnjë të drejtë.

Së fundi, marrëveshja, përveçse në Kanada, krijon hapësira ligjore për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë edhe në vendet e tjera, me të cilët këto dy vende kanë marrëveshje.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe shpresoj t'u përgjigjemi të gjitha pyetjeve të anëtarëve të komisionit!

Zoti kryetar, në mirëkuptimin e deputetëve, në orën 10:30 është mbledhja e Komisionit të Ekonomisë dhe më duhet të jem atje, por që me pyetjet e tjera mund të vazhdojnë kolegët e mi.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zonja Ministre!

Për të respektuar orarin e Komisionit të Ekonomisë, jeni e lirë të lëvizni dhe ne mund të vazhdojmë me zëvendësministren dhe zotin Kuka.

Fjalën e ka zonja Bushka.

Klotilda Bushka- Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo është një marrëveshje që vjen në vazhdën e të gjitha marrëveshjeve në lidhje me sigurimin e të gjithë emigrantëve, që ndodhen në vende të ndryshme të botës. Përpjekjet për të arritur dhe konkluduar marrëdhënie të sakta me vende të ndryshme të botës marrin kohë, siç ka marrë edhe kjo marrëveshje. Unë e di që kjo marrëveshje ka marrë një kohë të gjatë për t'u diskutuar dhe konkluduar deri sa ka arritur në Kuvend, kështu që më mirë vonë se kurrë dhe ju përgëzoj që keni arritur deri këtu. Kjo është një marrëveshje e rëndësishme, sepse janë rreth 60 mijë emigrantë në Kanada, të paktën kështu është në relacion...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të nderuar kolegë, kjo është shumë e rëndësishme, sepse flasim për shtetasit shqiptarë jashtë vendit dhe për këtë arsye është shumë e rëndësishme që të vijmë në këtë fazë.

Për të gjithë ata që u takon, në përputhje të harmonizuar me legjislacionin e Kanadasë dhe të Shqipërisë, vetë marrëveshja jep përfitime për emigrantët, të cilët kanë të drejtën të dalin në pension pleqërie, për ata që janë në kushtet e përfitimit të pensionit të invaliditetit dhe për ata që janë në kushtet për të përfituar pensione familjare. Është shumë e rëndësishme që të gjitha harmonizimet që janë kryer dhe janë materializuar në marrëveshje janë në përputhje të plotë edhe me rregulloret e Këshillit të Parlamentit Europian, si dhe atë të Këshillit Europian, sepse në kushtet kur Shqipëria aspiron të jetë sa më parë pjesë e BE-së, detyra jonë është përafrimi me standardet e atyre vendeve. Kështu që në këtë pikëpamje mendoj se akti është i qartë, ku në thelb është si të gjitha marrëveshjet që në kemi ratifikuar me vendet e tjera të botës dhe do të doja që të arrinim në këtë fazë edhe për Italinë dhe Greqinë, ku numri i emigrantëve është i lartë.

Kam një pyetje, e cila lidhet me efektet financiare. Në relacionin bashkëngjitur projektligjit ju thoni që ky numër prej 60 mijë apo 70 mijë emigrantësh nuk do të jetë në kushte për ta përfituar menjëherë pensionin, sepse ka ende vite që të përfitohet pensioni, pra të arrihet mosha për të përfituar pension. A keni bërë ju një studim të saktë të këtyre kategorive moshore? Sepse mund të ndodhë që të ketë njerëz, të cilët dalin në pension vitin që vjen ose menjëherë sapo kjo marrëveshje të hyjë në fuqi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në relacion shoh që thoni: “Nuk ka efekte të menjëhershme financiare në buxhetin e shtetit”. Në fakt, mendoj se efektet financiare në këto raste e kanë rëndësinë e tyre, por më e rëndësishme është t’u japim efektivisht të drejta shtetasve që u takojnë.

Thjesht për qartësim: dua të di se çfarë ndodh në qoftë se personat nuk do të dalin në pension pas njëfarë kohe, siç e keni parashikuar ju planifikimin buxhetor, por dalin më herët. A përfitojnë këta persona, apo jo?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Po, zonja Denaj.

Anila Denaj – Në fakt, një përgjigje më definitive do t’ua lë kolegëve ta japin, por konteksti i buxhetit është një kontekst, që ne e kemi parashikuar brenda analizave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ku kjo gjë është e parashikuar brenda buxheteve të tyre, pra se nuk do të ketë efekte shitesë në projeksionet që ne kemi.

Sigurisht, ka efektin kohë, sikurse ka edhe efektin numër, që në kontekstin shqiptar vjen më i reduktuar si efekt buxhetor sesa për vendin me të cilin është lidhur marrëveshja, që mund të jetë edhe një nga argumentet pse ka vonesa me vendet tjera, si Italia, Greqia. Kjo është sot

një pikë dhe një ngërç në diskutim, që ndoshta kolegët do ta sqarojnë se në çfarë faze është secili.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Kuka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të vazhdoni, zonja Ministre. Shumë faleminderit për prezencën në komision!

(Ministrja e Financave largohet nga mbledhja.)

Po, zoti Kuka.

Astrit Kuka – Faleminderit!

Në fakt, çështja e efekteve financiare është pak e vështirë të përcaktohet realisht, sepse duhet të njihen në mënyrë shumë ekzakto grupmoshat, vitet që kanë punuar në Shqipëri, vitet që kanë punuar në Kanada e të tjera. Por nga një studim që është kryer, rezulton se duhet të ketë minimalisht tetë vjet në Kanada që të futet në skemën e sigurimeve shoqërore.

Gjithsesi, skema e sigurimeve shoqërore në Shqipëri ka parashikuar çdo rast dhe përfitues janë të gjithë ata persona që nga momenti kur marrëveshja hyn në fuqi. Duhet të theksojmë që marrëveshja hyn në fuqi katër muaj pasi të ratifikohet edhe nga Kanadaja, pra pas shkëmbimit të instrumentit të ratifikimit.

Për ta ilustruar këtë, mund të themi që edhe në raste të tjera nuk jemi shprehur për efekte financiare të drejtpërdrejta, por ne e kemi filluar zbatimin. Në shumë marrëveshje, vazhdimisht po trajtohen praktika qoftë në marrëveshjet me Turqinë, me Kanadanë, me Belgjikën, me Luksemburgun, me Maqedoninë, pra kemi trajtuar vazhdimisht raste të caktimit të pensionit apo të dhënies së periudhave të sigurimit e të tjera. Puna vazhdon normalisht. Nuk diskutohet që çdo person, i cili plotëson kushtet në datën kur hyn në fuqi, nuk ka probleme, sepse është parashikuar në buxhet të shtetit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Kuka!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, kjo marrëveshje, siç e tha edhe relatorja, shkon në interes shumë të madh edhe të palës shqiptare, por, duke e parë në kontekstin analitik, a është studiuar sa është numri i kanadezëve që punojnë në Shqipëri?

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Kuka.

Astrit Kuka – Në fakt, për kanadezët në Shqipëri kërkohet një periudhë shumë e gjatë që të jenë përfitues, pasi skema e tyre i garanton, edhe kur janë jashtë vendit, që të marrin pension nga vendi i tyre. Pra, kanadezët do të jenë shumë pak përfitues.

Numri i tyre është llogaritur vetëm për ato kompani, që kanë punuar në industrinë e naftës, të cilat tani janë pakësuar, sepse ato ishin në skemën e sigurimeve shoqërore të Shqipërisë. Ne kemi parimin: aty ku punohet, do të paguhet kontributet. Ndërkohë, me marrëveshje, deri në 24 muaj do të trajtohen përsëri nga skema e sigurimeve shoqërore me të gjitha përfitimet që ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi një numër ekzakt sa kanadezë janë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Kuka!

Fjalën e ka kërkuar zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Kuka! Ju përgëzoj për projektligjin që sillni “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore”...

Besoj që është një periudhë e gjatë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka vite që diskutohet dhe është arritur dakordësimin i kësaj marrëveshjeje.

Dua t’i rikthehem shqetësimit ose pyetjes që ngriti me të drejtë kolegja Bushka lidhur me numrin e përfituesve, të emigrantëve. Kemi miratuar një ligj “Për regjistrimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit” dhe, në këtë kuadër, besoj se edhe ai regjistrim do të na ndihmojë për të ditur numrin real të emigrantëve që banojnë, që janë regjistruar dhe punojnë në vende të tjera, përfshirë këtu edhe Kanadanë.

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Katër muaj, një vit... Domethënë, do të hyjë një ditë dhe do të jetë shpejt. Cilat janë detyrimet që kanë qeveria shqiptare, por edhe qeveria kanadeze për ta bërë këtë marrëveshje realisht efektive?

Në faqen gjashtë të relacionit ju thoni që periudha e zbatimit do të jetë 6 vjet deri në 10 vjet. Po jua them unë, që disa miq të mi mund ta fillojnë që vitin tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse kanë emigruar që në vitin 1992 në Kanada, në fushën e naftës, dhe kanë 15-20 vjet punë në Shqipëri. Shtroj pyetjen: cila periudhë do të llogaritet periudhë pensioni nga e cila

do të lindë e drejta për të marrë pension, periudha e Shqipërisë, bie fjala për ata që kanë 35 vjet punë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

15 vjet? Ata e kanë bërë që në kohën e atëhershme 15-vjetëshin, kur kanë emigruar. Apo do të keni parasysh edhe legjislacionin kanadez? E bëj këtë pyetje, pasi në relacion (i cili është i mirëpërgatitur) ka disa momente që duhet të sqarohen për të parë efektivitetin dhe kur fillon ndikimi ose impakti i këtij projektligji që do të ratifikojmë.

Pyetja e dytë: a është ndërmarrë ndonjë fushatë njohëse sensibilizuese për popullsinë shqiptare që jeton në Kanada? Në këtë kuadër, meqenëse ka pasur disa pyetje pas miratimit të marrëveshjes me Austrinë, por edhe tani me Kanadanë, në çfarë faze janë në bisedimet me Italinë dhe Greqinë?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zoti Kuka.

Astrit Kuka – Faleminderit!

Kuptohet që të gjitha këto pyetje jo vetëm qëndrojnë, por, në fakt, janë esenciale në trajtimin e marrëveshjeve. Ne garantojmë, sepse e garanton vetë marrëveshja në nenin e parafundit të saj që “Përfitues është çdo person, i cili plotëson kushtet në ditën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes”.

Fakti që ne kemi thënë se duhen 8 vjet deri në 10 vjet për këto, është për të bërë një llogaritje nëse e cenonte buxhetin e shtetit, në mënyrë të veçantë. Pra, për këtë periudhë nuk do të cenohet buxheti i shtetit veçanërisht vetëm pse hyri në fuqi marrëveshja. Ato janë parashikuar brenda buxhetit të sigurimeve shoqërore, ndërsa persona të veçantë dhe jo fare të veçantë, por me qindra do të jenë ato që do të përfitojnë menjëherë, sepse interesimi është i jashtëzakonshëm: ka katër vjet që njerëzit paraqiten vazhdimisht pranë zyrave tona, pse nuk fillon, pse ka ngecur... Por realisht problemet nuk janë teknike këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të jeni të sigurt që marrëveshja u vonua thjesht për fazën e nënshkrimit. Qeveria atje ndryshoi, pati disa probleme të kësaj natyre... Ndërkohë që marrëveshja teknikisht kishte mbaruar që në vitin 2015.

Pra, është absolutisht e sigurt që nga kjo marrëveshje përfiton çdo person në ditën kur kjo marrëveshje hyn në fuqi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë përfiton? Kjo është marrëveshje e veçantë në lidhje me të gjitha marrëveshjet e tjera dhe është marrëveshja më favorizuese për shqiptarët që është bërë ndonjë herë. Kjo, falë dakordësisë së palës kanadeze, jo të meritës sonë, sepse pala kanadeze konsideron si periudhë vjetërsie, për efekt të bashkimit të periudhave, edhe vjetërsinë thjesht të qëndrimit në Kanada. Pra, në qoftë se një shtetas ka qëndruar dhjetë vjet në Kanada, sistemi kanadez i jep atij një përfitim rezidencial në Kanada. Po të ketë nëntë vjet, nuk i jep asgjë. Po të ketë mbi njëzet vjet në Kanada, i jep një përfitim, të cilin mund ta transferojë edhe në Shqipëri.

Me anën e marrëveshjes, duke bashkuar periudhat e sigurimit, në qoftë se një shtetas ka pesë vjet në Kanada si rezidencial, por ka punuar 15 vjet në Shqipëri, ai e merr pensionin rezidencial të Kanadasë, të cilin duhet ta merrte pas 20 vjetësh, që në momentin e parë me bashkim periudhash sigurimi. Kjo është një ndër përfitimet ekstra, që e përfitojnë masivisht shtetasit shqiptarë në Kanada. Ky është thelbi i kësaj i marrëveshjes.

Për sa i përket sensibilizimit, faktikisht ne nuk kemi bërë ndonjë gjë të veçantë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në takimin që kemi pasur atje po. Por i ka bërë televizioni dhe njerëzit janë të njohur shumë mirë me këtë marrëveshje. Natyrisht, sensibilizimi vazhdon për procedurat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë përgatitjesh kemi bërë ne? Përveç marrëveshjes bazë, është miratuar dhe është nënshkruar një marrëveshje administrative, shumë më e gjatë se kjo, që përcakton në mënyrë rigorozë veprimet që bën secila palë. Njëkohësisht, janë miratuar disa formularë standardë me anën e të cilëve bën kërkesën çdo person. Formularët janë fare të thjeshtë, të unifikuar dhe që në momentin e parë mjafton të plotësohet një formular qoftë për të përfituar në Kanada ose në Shqipëri ose mund të jetë në Kanada për të përfituar në Shqipëri, dhe ne e quajmë çdo letër që ai bën nga Kanadaja. Gjithashtu, parashikohet që edhe çështjet postare jashtë çdo pagese ekstra i merr përsipër marrëveshja, palët...

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Kuka!

Fjalën e ka kërkuar për pyetje zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dua të marr më shumë një informacion, sepse rrallë shkojmë në ato shtete, në fakt. Disa burra të vjetër, që duan të kthehen në Shqipëri, ngrenë shqetësimin nëse mund ta përfitojnë këtë pension. Pra, përfshihet kjo në marrëveshje, apo jo? A mundet që pensioni që ata marrin atje ...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, sepse ka disa që duan të treten në Shqipëri.

Ulsi Manja – Po, mund ta ...

Dajna Sorensen – Zoti Kuka sapo shpjegoi që kjo marrëveshje siguron pikërisht aspektin e transferimit të pensionit për ata, të cilët periudhat e përbashkëta kontributive arrijnë 20 vjet të mund ta transferojnë pensionin e tyre në Shqipëri. Edhe në shembullin që zoti Kuka sapo përmendi, në qoftë se personi ka 5 vjet në Kanada, qoftë edhe rezident, dhe ka 15 vjet apo 25 vjet punë në Shqipëri, mjafton që shumatorja e këtyre të dyjave të shkojë mbi 20 vjet punë, automatikisht ata mund ta marrin pensionin fizikisht në Shqipëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kuptohet, vetëm për Kanadanë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – A mund ta marri në Shqipëri?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dajna Sorensen – Nëse ka mbi 20 vjet punë në total, absolutisht po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka problem, le të kenë dalë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Zonja Mara ka pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ke diskutim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Aurora Mara - Së pari, doja të falenderoja zonjën Bushka për relatimin dhe qartësimin!

Për të thënë të drejtën, kjo marrëveshje që qeveria shqiptare lidh me qeverinë e Kanadasë është shumë e rëndësishme dhe jashtë mase thelbësore për të gjithë emigrantët shqiptarë në Kanada. Njohja e paketës shoqërore është gjë shumë e rëndësishme për ata që jetojnë atje. Unë dua t'u kërkoj të gjithë kolegëve që ta miratojmë këtë marrëveshje dhe shpresoj që në vazhdim të kemi marrëveshje të tilla, të cilat janë jashtë mase në ndihmë dhe në favor të të gjithë emigrantëve që jetojnë jashtë vendit tonë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

Nuk besoj se ka pyetje të tjera nga kolegët. Diskutime nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të kësaj marrëveshjeje.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë”? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E votojmë në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kanadasë”.

Raporti relatorës t’i përcillet komisionit përgjegjës dhe më pas parlamentit për votim në seancë plenare.

Zonja Sorensen, zoti Kuka, shumë faleminderit për prezencën sot në komision dhe ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.09.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit, për transportin detar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Alban Zeneli, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Xhemal Qefalia dhe Edlira Bode.

Mungojnë:

Edmond Leka ,Alket Hyseni, Bashkim Fino, Spartak Braho, Damian Gjiknuri, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Artan Shkreli - Zëvendësministër

Thimjo Plaku - Drejtor i përgjithshëm

Bledar Karoli - Përgjegjës sektori

Elson Thana - Specialist

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e katërt dhe të fundit të rendit të ditës, që është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit, për transportin detar”. Edhe në këtë marrëveshje ne jemi komision për dhënie mendimi, kurse relator do të jetë kolegu Jurgys Çyrbja. Kemi prezent nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës zotin Artan Shkreli, zëvendësministër, si dhe stafin e ministrisë që shoqëron zotin Shkreli.

Ju lutem, zini vendet!

Zoti Shkreli, mirë se keni ardhur në komision!

Ju lutem të bëni një prezantim të shkurtër të kësaj projekt marrëveshjeje dhe pastaj do ta kenë fjalën zoti Çyrbja dhe kolegët për pyetje dhe diskutime nëse do të kenë.

Fjala është për ju.

Artan Shkreli – Mirëdita të gjithëve!

Bëhet fjalë për marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit, për transportin detar, e cila duhet ratifikuar në parlament. Është hera e parë që bëhet një marrëveshje e tillë me këtë vend. Katari është një gadishull i vogël në Gadishullin e madh Arabik, me një popullsi më pak sesa gjysma e tonës dhe me një *per capita* dhjetëfish sa ne, si të gjitha vendet që kanë qenë nën Britaninë e Madhe deri në vitet ‘70. Mendojmë që kjo është një marrëveshje kuadër, e cila nuk ndryshon nga marrëveshjet e tjera që kemi me vende të ndryshme për lundrimin detar. Nuk ka asnjë specifikë në raport me marrëveshjet ekzistuese dhe nuk ka asnjë specifikë as marrëdhënia jonë me shtetin e Katarit. Në këtë pikëpamje dua të theksoj që kjo marrëveshje nuk sjell kosto financiare.

Ratifikimi i marrëveshjes është një akt që siguron lundrimin e lirë me të drejta reciproke, pra, ka reciprocitet të plotë në të gjitha nenet e veta dhe në të gjithë frymën që përshkon këtë marrëveshje, si dhe, nga ana tjetër, rrit gjeografinë e lundrimit edhe për flotën tonë me të drejtat përkatëse. Deri tani, në mungesë të kësaj marrëveshjeje, flotiljet tona kanë lundruar nën flamurë të tjerë ose me skamotazhe të ndryshme. Pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, kuptohet që e gjitha futet brenda një kuadri ligjor reciprok.

Nuk dua të zgjatem në specifikimin dhe citimin e neneve të ndryshme, sepse ato i ka secili prej jush përpara, duke pasur parasysh faktin që kjo nuk ndikon as në *Acquis communautaire*, sepse nuk është pjesë që ndikon në raportet me Bashkimin Europian ose në aktet, kështu që nuk kemi as tabela dhe as formularë shtesë në raport me këtë.

Doja të thosha që bazohet në të gjitha konventat, qoftë Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, nga njëra anë, por reflekton në mënyrë besnike dhe bazohet në të gjithë

legjislacionin tonë në fuqi, pa pasur nevojë të bëhen VKM specifike apo për të ndërmarrë ndryshime ligjore.

Nëse ka ndonjë pyetje për nenet, jemi të gatshëm t'u përgjigjemi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shkreli!

Po, zoti Çyrbja.

Jurgys Çyrbja – Faleminderit, zoti kryetar!

Para se të filloj me relatimin dua të them që kjo marrëveshje vjen direkt pas vizitës së një anijeje me vela 80-vjeçare nga Katari, të quajtur Fatah Al Khair 4, që është ankoruar para disa ditëve në portin e Durrësit, e cila kishte si qëllim promovimin e kampionatit botëror që zhvillohet në shtetin e Katarit në vitin 2022. Për këtë dua të falenderoj ambasadorin e Katarit, i cili na u gjind dhe na respektoi me atë vizitë!

Gjithsesi, qëllimi i kësaj marrëveshjeje është ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit, për transportin detar. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon forcimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve në fushën e transportit detar në bazë të parimeve të lundrimit të lirë duke marrë parasysh parimin e barazisë, të bashkëpunimit dhe përfitimeve të ndërsjella.

Kjo marrëveshje bazohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për ligjin e detit, si dhe në konventa të tjera ndërkombëtare për sigurinë e transportit detar, lehtësimin e transportit detar ndërkombëtar, kushtet e jetës dhe të punës së detarëve, transportin e mallrave të rrezikshme dhe mbrojtjen e mjedisit detar. Kjo marrëveshje përbëhet nga 16 nene, të cilët bazohen në të drejtën ndërkombëtare, si dhe në kuadrin ligjor kombëtar të secilit shtet.

Hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje parashikohet të jetë në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja do të jetë e vlefshme për 3 vjet, si dhe do të rinovohet automatikisht për një periudhë apo periudha të tjera të ngjashme, duke mbetur në fuqi derisa njëra nga palët kontraktuese të njoftojë palën tjetër me shkrim se kërkon të përfundojë këtë marrëveshje.

Në aspektin ligjor dhe procedural vlerësoj se projektligji është në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si dhe Rregulloren, prandaj ftoj anëtarët e komisionit ta votojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji.

Pro? Kundër? 3 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. Duhet parë relacioni.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? 3 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? 3 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Pro? Kundër? 3 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit, për transportin detar”.

Raporti i relatorit t’i përcillet komisionit përgjegjës dhe më pas për votim në seancë plenare.

Faleminderit, zoti Shkreli dhe kolegët që ju shoqëruan sot në Komisionin e Ligjeve!

Me votimin e këtij projektligji e mbyllim për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve. Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës, do t’ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA